VENDIM
Nr. 208, datë 27.6.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 64, DATË 8.4.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'GEGA-G' SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1753/2 prot., datë 22.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Gega-G' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'GEGA-G' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 8.4.2020, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "Gega-G" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor me objekt shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 7647/7 prot., datë 29.3.2016, të depozitojë në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.

3. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1753/1 prot., datë 20.6.2023, shoqëria ka depozituar në ERE vendimin nr. 596, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, ku është vendosur shfuqizimi i aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 7647/7 prot, datë 29.3.2016". Me depozitimin e këtij vendimi, rezulton se ky kusht është plotësuar, ndaj si i tillë vlerësohet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 64/2020, nuk gjen më zbatim as pika 3 e këtij vendimi, e cila po ashtu vlerësohet të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Gega-G" sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti